

Asistenca e Riintegrimit

Shpjegimi i mënyrave të pagesave të IOM-it

- Ju duhet të kontaktoni zyrën e IOM-it, **brenda tre muajve** pas kthimit.
- Ju duhet të dëshmoni **identitetin** tuaj (me pasaportë / leje njoftimi).
- Pagesat mund të bëhen vetëm për personat me **status legal** në vendet e kthimit (lutemi vini re, mund të keni nevojë për një leje qëndrimi dhe pune nëse ktheheni në një vend të tretë).
- Lutemi vini re, nëse jeni duke themeluar një biznes, **ky biznesi duhet të jetë legal dhe i regjistruar në mënyrë ligjore** dhe ju duhet të dorëzoni një kopje të licencës së biznesit tuaj pranë IOM-it.
- Ju duhet të **bashkëpunoni me stafin e IOM-it** në realizimin e projektit tuaj të riintegrimit.
- Asistenca e Riintegrimit mund të jepet vetëm **brenda një viti pas kthimit** (përveç rasteve me autorizim të posaçëm nga ana e Sekretariatit të Shtetit për Migracionin (SEM)).
- **Ndryshimet e projekteve të riintegrimit duhet të jenë të autorizuar** para se të kryhet çdo pagesë.
- Shuma e përmendur në marrëveshje është një **shumë maksimale**. Nëse ju shfrytëzoni më pak se kjo shumë e miratuar nga SEM ose donatori për projektin tuaj të riintegrimit, vetëm shumën që keni shpenzuar dhe që është e dëshmuar me fatura do të jetë e **mbuluar**.
- Pagesat bëhen në **këste të ndryshme** për zbatimin e projektit tuaj të riintegrimit që është miratuar nga SEM ose donatori.
- Pagesa e ndihmës së riintegrimit mundësisht kryhet **direkt te ofertuesi / furnizuesi / pronari, mjeku apo farmacisti** në varësi nga lloji i asistencës së riintegrimit.
- Në qoftë se një pagesë direkte nuk është e mundur, do të duhet t'i **paraqitni faturat / dëftesat** në lidhje me shpenzimet për projektin tuaj dhe keto shpenzime **do të MBULOHEN**.
- **PAGESA ASNJËHERË nuk kryhet me para në dorë**.
- Pagesa bëhet zakonisht në **monedhën vendase, dhe asnjëherë në CHF (franga zvicerane)**.
- Shuma e asistencës së riintegrimit në dollarë amerikanë (USD) përcaktohet nga SEM në bazë vjetore.
- **Kursi mujor i këmbimit valutës të IOM-it** që përdoret për pagesa është baza e konvertimit të USD në monedhën vendase (kryesisht ndryshon nga normat e zakonshme bankare të këmbimit ditor!).

Komunikimi

- **Para kthimit:** Nuk ka komunikim të drejtëpërdrejtë me zyrën e IOM-it në vend të kthimit; personi kryesor i kontaktit në Zvicër është këshilltari i kthimit.
- **Pas kthimit:** zyra lokale e IOM-it do t'i përgjigjet pyetjeve tuaja dhe do të ju ndihmojë në zbatimin e projektit (jo këshilltari për kthim në Zvicër); kështu, personi i kontaktit është stafi lokal i IOM-it.